

DEKLARATË

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

Duke ndjekur ecurinë e procesit të përcaktimit të statusit përfundimtar të Kosovës;

Duke vlerësuar veprimtarinë e Grupit të Kontaktit dhe veprimtarinë e deritanishme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për çështjen e Kosovës;

Duke konsideruar shumë të rëndësishme zgjidhjen e shpejtë të statusit të Kosovës për sigurinë e stabilitetin në rajon;

- **Vlerëson** maksimalisht veprimtarinë e kryenegociatorit Ahtisari dhe rikonfirmon mbështetjen për paketën e propozuar prej tij, si një zgjidhje realiste për statusin e Kosovës;

- **Çmon kontributin e qëndrimet e qarta** të SHBA-së dhe BE-së dhe konsideron shumë të rëndësishëm rolin e të gjithë faktorëve globalë gjatë të gjithë procesit dhe në mënyrë të veçantë në fazën përfundimtare të përcaktimit të statusit të Kosovës;

- **Shpreson dhe beson** në vendimmarrjen konsensuale dhe miratimin e shpejtë të një rezolute nga Këshilli i Sigurimit, mbi bazën e propozimeve të përfshira në paketën e Ahtisarit, si zgjidhja që garanton siguri e stabilitet në Kosovë e rajon;

- **Përgëzon** qytetarët dhe elitën politike të Kosovës për maturinë e treguar dhe bashkëpunimin e ngushtë me faktorin ndërkombëtar dhe i fton ata që, sikurse deri më sot, të vazhdojnë të dëshmojnë respektin dhe kohezionin e tyre rreth vlerave të lirisë dhe demokracisë, si një kusht dhe si një kërkesë e vazhdueshme e partnerëve ndërkombëtarë për të merituar pavarësinë në shërbim të paqes dhe prosperitetit në Kosovë dhe në rajon;

- **Rikonfirmon** qëndrimet paqësore konstruktive dhe aktive të Shqipërisë në çështjet e politikës rajonale dhe më gjerë dhe nxit e inkurajon Qeverinë për të dhënë kontributin maksimal që çështja e statusit të gjejë zgjidhje brenda agjendës së parashikuar.

10 maj 2007